



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2298/7 Prot

Rrëshen më, 06 . 08 2025

V E N D I M

Nr. 57 datë 01. 08. 2025

**“PËR MIRATIMIN , VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E
ZJARRIT NË BANESËN E Znj. MARË PRENG SINANAJ , FSHATI BUKMIRË,
NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”, BASHKIA MIRDITË DHE PËRDORIM
FOND I MBROJTJES CIVILE**

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.45/2019 “Per mbrojtjen civile”, në ligjin nr.115/2024, “Per buxhetin e vitit 2025”, “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr.115 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, si dhe projekt-vendimin së bashku me relacionin nr. 2298 datë 14.07.2025, të komisionit të ngritur me Urdhër Nr. 255 datë 16.06.2025 nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve, të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Marë Preng Sinanaj, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit*, për t’a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Marë Preng Sinanaj, nga i cili është shkaktuar djegia pjesërisht e banesës, si dhe janë dëmtuar orendi dhe paisjeve elektroshtëpiake, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni, në masën **550,761.09 lekë (pesëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë nëntë) lekë**, nga ku:
 - a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **348,861.09 lekë**,
 - b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake: **201.900 lekë**

ADRESA SHIESHI "ABAJ DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

2. Bashkia Mirditë nga fondet e kushtëzuara të mbrojtjes civile akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit Znj. Marë Preng Sinanaj, në masën **275 380 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë)** lekë, përdorimi i fondit si më poshtë:

▪ **Përdorim fondi, Mbrojtje Civile; (Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB), për shumën 275 380 lekë**

3. Dosja e plotë e dokumenteve; (relacion, urdhër, procesverbal - konstatimi, prevetivat, planimetria e banesës dhe vërtetim rënie zjarri), *bashkëlidhur pjesë përbërse e këtij vendimi*
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat & Agjensia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave)

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAËU





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2238 / Prot.
6

Rrëshen, me 14/07 /2025

P/V E N D I M

Nr. 60 datë 14.07.2025

**“PËR MIRATIMIN , VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E
ZJARRIT NË BANESËN E Znj. MARË PRENG SINANAJ , FSHATI BUKMIRË,
NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”, BASHKIA MIRDITË DHE PËRDORIM
FOND I MBROJTJES CIVILE**

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjin nr.115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", dhe relacionin e komisionit të ngritur me urdhër Nr. 255 datë 16.06.2025 nga Kryetari i Bashkisë për verifikimin e dëmeve, të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Marë Preng Sinanaj, këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Marë Preng Sinanaj, nga i cili është shkaktuar djegia pjesërisht e banesës, si dhe janë dëmtuar orendi dhe pajisjeve elektroshtëpiake, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni, në masën **550,761.09 lekë (pesëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë nëntë) lekë**, nga ku:
 - a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **348,861.09 lekë**,
 - b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake: **201.900 lekë**.
2. Bashkia Mirditë nga fondet e kushtëzuara të mbrojtjes civile akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit Znj. Marë Preng Sinanaj, në masën **275,380 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë**, përdorimi i fondit si më poshtë:

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

Fondi mbrojtje civile(Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB)për shumën 275,380 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICA KU

Paraqiten projektin

Dr. AIKE:

F.Vorfi

Dr.Juridike, prok, protokoll:

M. Doda

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

KRYETARI
Albert MELYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2238/5 Prot.

Rrëshen, me 14/07 /2025

RELACION

**PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR “MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE
TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Znj. MARË PRENG SINANAJ,
FSHATI BUKMIRË, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”**

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Mirditë

Të nderuar këshilltarë,

Me datën 12.06.2025 në Fshatin Bukmirë, të NJ.A Rrëshen, në banesën e **Znj. Marë Preng Sinanaj** ka rënë zjarr duke e djegur pjesërisht atë ku i janë dëmtuar orendi dhe paisje elektroshtëpiake si dhe janë konstatuar dëme nga ana ndërtimore.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të VKM Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kreu 111, pika 1 gërma b” dhe me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me Nr. 255 datë 16.06.2025 u ngrit komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën Znj. Marë Preng Sinanaj. Është mbajtur proces-verbali i konstatimit, evidentimi i subjektit të dëmtuar, ku në banesën e shtetasit Marë Preng Sinanaj nga rënia e zjarrit u konstatua: është djegur kuzhina me të gjitha pasisjet elektroshtëpiake, tavolina, karrige, televizor, krevate, minibar, ka dëmtime të rrjetit elektrik, dëmtime suvatimi, pllaka, dyer dhe dritare të dëmtuara, prezence tymi në gjithë ambjentin e shtëpisë, etj ku më të detajuara jepen në procesverbalin e konstatimit, preventivin e vlerësimit të dëmeve në orendi, pajisje, elektroshtëpiake si dhe në preventivin në dëmet nga ana ndërtimore.

Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është **201,900 lekë**.

Preventivi i vlerësimit të dëmeve nga ana materiale ndërtimore është **348,861.09 lekë**.

Vlera totale e dëmit të shkaktuar në banesë është **550,761.09 lekë**.

Pasqyrimi i djegies së banesës shoqërohet me fotografi si dhe vërtetimin për rënien e zjarrit nga Stacioni i MZSH-së Bashkia Mirditë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

Hartuan projektin:

Drejtori AIKE: Frederik VORFI

Përgj/ Sekt. EC: Ilir GJINI

KRYETARI
ALBERT MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2296 / Prot.
1

Rrëshen, me 16 / 06 / 2025

URDHËR

Nr. 155 Datë 16 . 06 . 2025

“ MBI NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Znj. MARË PRENG SINANAJ, FSHATI BUKMIRË , NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”


Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe të VKM Nr. 329, dt. 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Kreu III, pika 1, germa “b”.

URDHËROJ:

1. Të ngrihet komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z. Marë Preng Sinanaj, fshati Bukmirë, Njësia Administrative Rrëshen.
2. Përbërja e komisionit të jetë:

1. Gjin MANDREJA	Kryetar	Administrator i NJ. A Rrëshen
2. Mëhill PAÇUKU	Anëtar	Ing. Emergjencia Civile
3. Daisler PEPA	Anëtar	Ing. D.P.ZH.T
4. Kristjan MARKU	Anëtar	Specialist Taksash
5. Viktor VOKRRI	Anëtar	Specialist Emergjencia Civile


3. Vlerësimi i dëmeve të bëhet konformë , të VKM-s Nr. 329 datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III.
4. Të mbahet proces verbali i dëmeve të shkaktuara.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇT”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

SEKTORI MZSH

Nr. 300 Prot

Datë.26. 06. 2025

V Ë R T E T I M

Për rënie zjarri

Vërtetojmë se me datën 12.06.2025 ora 14:20 kemi marrë njoftim nga Salla Operative Komisariati Mirditë për ngjarjen zjarrit të rënë në banesen e shtetasit **Mare SINANAJ** në fshatin Bukmirë Njësia Administrative Rrëshen.

Vendi i zjarrit: Fshati Bukmirë , Njësia Administrative Rrëshen , Bashkia: Mirditë.

Nga konstatimi në vendin e ngjarjes deklarojmë se apartamenti në pronsi të shetasit **Mare SINANAJ** është djegur kuzhina pjesërisht, si dhe janë demtuar nga zjarri materiale të tjera dhe banesa në brendesin e sajë si pasoje e zjarrit dhe tymit.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarit me nr Prot 2298.
Datë 12.06.2025

SHEFI I SEKTORIT MZSH

AGIM LLESHAJ





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2298 / Prot.

Rrëshen, me 01 / 07 / 2025

PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me datë 16 .06 .2025 nga komisioni i ngritur me Urdhër nr. 253 . dt. 16 .06 .2025 të Kryetarit të Bashkisë, për verifikimin e ankesës së Z. Z/znj MARË PRENG SINANAJ banor i/e fshatit/qytetit BUKMIRE , Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë.

Në zbatim të VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", dhe të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, komisioni konstaton këto dëme:

a. Nga ana ndërtimore:

SALLONI : PLLAKA "SHITROJE", SYVATIMET KOMPLET
LYERTE ME BOTË, RRJETI ELEKTRIK
KORIDORI : PATINIM E LYERTE ME BOTË
DRITARE cop 2 (dy) DERË DRURI cop 1 (një)
DERË DURALUMINI cop 1 (një)
MË TË DETAJUARA JEPEX NE PREVENTIVIN E
VLERESIMIT TE DËMEVE NGA ANA NDËRTIMORE.

b. Në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake:

NGA RËNTA E ZJARRIT NË BANESË JANË DËMTUAR:
SOBE ELEKTRIKE cop 1 (një) TELEVIZOR cop 1 (një)
MINI BAR cop 1 (një) TAVOLINË E ZAKONSHMË SALLON
cop 1 (një) TAVOLINË BUKE cop 1 (një) DARRIKE
cop 6 (gjashtë), DIGITALB cop 1 (një) KREVAT TEK
+ DYSHIE cop 2 (dy) DOLLAP RROBASH cop 1 (një)
KULTUR TRESH cop 2 (dy) PERDE KOMPLET cop
1 (një) KOOKEDINE cop 1 (një) TAPET cop 1 (një)

Proces-verbali mbahet në 3 (tre) kopje dhe fuset në dosje për veprim të mëtejshëm.

KOMISIONI

1. Gjin MANDREJA

2. Ing. Mehdi PAÇUKU

3. Ing. Daisler PEPA

4. Kristjan MARKU

5. Viktor VOKERI

KRYETARI I BASHKISË
Albert MEZYSHI

ADRESA, SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2298 / 3 Prot

Rrëshen, me 01.07.2025

PREVENTIV

I
VLERËSIMIT TË DËMEVE NË ORENDI, MOBILJE DHE PAISJE
ELEKTROSHTËPIAKE

Familjari: Marë Preng Sinanaj

Adresa e familjarit: Fshati Bukmirë, Njësia Administrative Rrëshen

Shkaku i dëmit: Rënie zjarri, dëmtim banese

Nr	Orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Sobë elektrike	Copë	1 (një)	26.000	26.000
2	Televizor	Copë	1 (një)	23.000	23.000
3	Minibar	Copë	1 (një)	25.000	25.000
4	Tavolinë e zakonshme salloni	Copë	1 (një)	8.000	8.000
5	Tavolinë buke	Copë	1 (një)	12.500	12.500
6	Karrige	Copë	6 (gjashtë)	1.500	9.000
7	Digitalb	Copë	1 (një)	9.900	9.900
8	Krevar tek + dyshek	Copë	2 (dy)	10.000	20.000
9	Dollap rrobash	Copë	1 (një)	10.000	10.000
10	Kolltuk tresh	Copë	2 (një)	17.000	34.000
11	Perde komplet	Copë	2 (dy)	8.000	16.000
12	Komodinë	Copë	1 (një)	2.500	2.500
13	Tapete	Copë	1 (një)	6.000	6.000
	Shuma totale				201.900

Shuma totale 201.900 (dyqind e një mijë e nëntëqind) lekë

Shënim: çmimet e mobiljeve, orendive janë marrë sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

PREVENTIVOI
Kristjan MARKU

KOMISIONI

Gjin MANDREJA

Ing. Mëshill PAÇUKU

Ing. Daisler PEPA

Viktor VOKRRI

KRYETARË
ALBERT MELYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

Nr. 2298/4 Prot
Dt. 02.07.25



BASHKIA MIRDITE

PREVENTIV

VLERESIM DEMI NGA ANA NDERTIMORE

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ALBERT MEKËVSHI



PRONARI: MARE PRENG SINANAJ

ADRESA: FSHATI BUKMIRE, N.J.A. RRESHEN, NR.PAS. _____, ZK. _____

OBJEKTI: BANESE 2+1

SHKAKU: RENIE ZJARRI, DEMTIME TE BRENDSHME

NR.R.	NR.ANAL.	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	40	373.02	14,920.80
2	2.426/12	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	18	632.54	11,385.72
3	2.281	Heqje pllaka dyshemeje	m2	15	399.49	5,992.35
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	2	318.6	637.20
5	2.31	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	66	1,124.24	74,199.84
6	2.267/a	Shtrese pllaka grez porcelanat	m2	18	2,607.15	46,928.70
7	2.383/2	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e II-te.	m2	1.71	19,220.05	32,866.29
8	2.328	Patinim muri alloi (stuko)	m2	66	418.64	27,630.24
9	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	1.71	11,346.23	19,402.05
10	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfish xham	m2	3.24	11,444.81	37,081.18
11	2.404	Boje hidroplastike	m2	132	254.96	33,654.72
12	An.2	Dalje prize komplet	copë	3	8,148.00	24,444.00
13	An.1	Dalje drite komplet	copë	2	9,859.00	19,718.00
SHUMA Lek						348,861.09

Shenim: Cmimet jane sipas manualit te miratuar me VKM. Nr.216, date 13.04.2023.

Data e hartimit te preventivit 23.06.2025.

PREVENTIVOI
Ing. Mehil PAÇUKU

KOMISIONI

Gjin MANDREJA


Daislet PEPA

Kristjan MARKU

Viktor VOKRRI

PLANIMETRIA

BANESE MARE PRENG SINANAJ
BUKMIRE, N.J.A. RRESHEN.



HARTOI: Ing.Mehill PAÇUKU.